



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER RAJMONDA A. DYRMISHI
ADRESA NR.10, MYSLYM SHYRI, NR.
72/1, NR.2, NR.25
TEL: 682054578



VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 699
Tirane më 03/07/2024

07.18.07.2024
VËRTETOHET NJESIA ME
ORIGJINALIN FQ (15)
SEKRETARE REGJISTRIT
Samuel Topa



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2024052780046652623

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER RAJMONDA A. DYRMISHI



DATE 03/07/2024

NR REP 699

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 03 Korrik 2024, para meje Notere RAJMONDA A. DYRMISHI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, MYSLYM SHYRI, NR. 72/1, NR.2, NR.25, u paraqiten personalisht shtetasit:

NËNSHKRUESIT:

1. **Esat Musliu**, atësia Jakup, amësia Qerime, shtetas Shqiptar, lindur në Stebleve, Peshkopi dhe banues në Tiranë, me adresë Halil Bega; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 22/04/1946, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032706682 dhe nr. personal E60422015S .
2. **Spartak Pecani**, atësia Vilson, amësia Valentina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë M.Peza 3/19; Njësia Administrative Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 27/05/1952, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039409067 dhe nr. personal F20527051Q.
3. **Besim Kurti**, atësia Hysen, amësia Myzafere, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Alqi Boshnjaku; Nd. 40; H. 7; Ap. 7; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 16/10/1949, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033811920 dhe nr. personal E91016054B.
4. **Bujar Kapexhiu**, atësia Fiqri, amësia Lutfije, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Mihal Ciko; Nd. 6; H. 1; Ap. 12; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 24/03/1944, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035097865 dhe nr. personal E40324010G.
5. **Zamir Kokonozi**, atësia Bujar, amësia Jerina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Hafiz Sabri Koçi; Nd. 16; H. 1; Njësia Administrative Nr. 1; Njësia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 08/05/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034565141 dhe nr. personal H80508047Q.
6. **Saimir Kumbaro**, atësia Omer, amësia Mynire, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Myslym Shyri; Nd. 22; H. 26; Ap. 5; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 05/05/1945, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033920549 dhe nr. personal E50505129D.



7. **Eno Milkani**, atësia Piro, amësia Margarita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Gjergj Fishta; Nd. 30; H. 33; Ap. 57; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 05/03/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037410687 dhe nr. personal G90305295D.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterës, aktin STATUTI I SHOQATA E FILMIT AUDIOVIZUAL, ARTISTIK DHE DOKUMENTAR "F.A.A.D", të hartuar prej tyre jashtë kesaj zyre noterie, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

RAJMONDA A. DYRMISHI
Rajmonda A. Dymishi
TIRANE

[Signature]



7

**"STATUTI
I
SHOQATA E FILMIT AUDIOVIZUAL, ARTISTIK DHE DOKUMENTAR
"F.A.A.D"**

Ne shtetasit Esat Musliu, Spartak Pecani, Besim Kurti, Bujar Kapexhiu, Zamir Kokonozi, Saimir Kumbaro dhe Eno Milkani, ne mbështetje te ligjit Nr.7850, date 29.07.1994 Kodi Civil i Republike se Shqiperise, nenet 39-53, ligjit 8788, date 07.05.2001 "Për Shoqatat Jofitimprurese dhe ligjit Nr. 8789, date 07.05.2001 "Per Regjistrimin e Shoqatave Jofitimprurese", vendosem te themelojme Shoqatën e Filmit Audiovizual, Artistik dhe Dokumentar "F.A.A.D", si shoqate që funksionon me qëllim administrimin e te drejtave te Filmave Audiovisual Artistik dhe dokumentar, Producentive te saj dhe autoreve, krijues dhe bashkëkrijues te veprave audiovizuale krijimeve te tyre, sipas aktit te themelimit. Kjo shoqate eshte nje organizate e krijuar me vullnetin e lire te anëtareve te saj pa asnje qëllim fitimi, joqeveritare dhe e pavarur.

Në bazë të legjislacionit civil shqiptar, ligjit Nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat Jofitimprurëse", të ndryshuar dhe ligjit Nr. 8789 datë 07/05/2001 "Për Rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", me vullnetin tonë të lirë miratojmë Statutin e Shoqates si më poshtë:

Neni 1

Emri, Forma, Selia dhe Simbolat

1. Emri i organizatës është **"SHOQATA E FILMIT AUDIOVIZUAL, ARTISTIK DHE DOKUMENTAR**. në formë të shkurtuar: **"F.A.A.D"**.

2. Forma e organizatës është ajo e Shoqatws.

3. Selia e Shoqatws ndodhet në Tiranë, në adresën Rruga **Adresë Rr.Him Kolli, Pall 43, Ap.12, Njësia Administrative Nr.4**. faad.alb@gmail.com; Website: www.faad-alb.com, nr. Tel/fax +355 4222 38 30.

4. Agjencia ka vulën dhe emblemen e saj.

a) Vula e Shoqatës është:

Katrore, me shkrimin e plote të Shoqatës, dhe inicialet e saj.

b) Emblema e Shoqatës është: F.A.A.D

Neni 2

Qëllimi i veprimtarisë së Shoqatës

1. Shoqata ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të Filmave Audiovisual Artistik dhe





8

dokumentar, Producentëve të saj dhe autorëve, krijues dhe bashkëkrijues të veprave audiovizuale – në zërat:

- Regji,
- Skenar,
- Drejtor fotografie,
- Producent.

me të gjitha mjetet ligjore dhe praktike sipas parashikimeve të kuadrit ligjor ekzistues në Republikën e Shqipërisë.

2. Shoqata është organizatë e pavarur jofitimprurëse, që ka për qëllim të sigurojë mekanizma e realizojë veprimtari për përmbushjen e qëllimit dhe të veprimtarisë së vet, vetëm ose në bashkëpunim me subjekte të tjera, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Shoqata në realizimin e qëllimit të vet është e hapur për bashkëpunim për çdo subjekt e individ, brenda dhe jashtë vendit, që kontribuon me çfarëdolloj forme në përmbushjen e objektivave të këtij qëllimi.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë

Në përmbushje të qëllimit të saj, Shoqata angazhohet në kryerjen e veprimtarive si vijon:

1. Përfaqësimi i interesave lidhur me të drejtat e autorit të secilit anëtar të Shoqatës përpara institucioneve shtetërore dhe subjekteve private sipas dhënies së autorizimit/kontratë për përdorim të objektit të së drejtës së autorit të nënshkruar ndërmjet Shoqatës dhe anëtarit, si dhe mbi bazën e një prokure të lëshuar nga anëtarë;
2. Monitorimi i shfaqjes së filmit artistik, dokumentar dhe çdo veprë audiovizuale me të drejta të anëtarëve të Shoqatës nga transmetuesit lokalë, kombëtarë dhe të huaj dhe mbledhja e shpërblimeve të të drejtës së autorit, për anëtarët e vet; autorë ose bashkëautorë të këtyre veprave;
3. Përfaqësimi i anëtarëve të Shoqatës në procedurat gjyqësore ose administrative dhe kryerja e çdo veprimi tjetër ligjor të nevojshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të administruara nga Shoqata;
4. Përcaktimi i tarifave të shpërblimit të të drejtës së autorit, për transmetimin e veprave audiovizuale nga operatorët, në të cilat anëtarët e Shoqatës janë autorë ose bashkëautorë;
5. Mbledhja e tarifave të shpërblimit, në emër dhe për llogari të anëtarëve, nga transmetuesit që shfaqin veprat me autorësi ose bashkëautorësi të anëtarëve të vet, sipas pjesëve të caktuara në veprat përkatëse të anëtarëve dhe kalimin e mjeteve monetare të përfuara tek autorët-anëtarë sipas kushteve të kontratës individuale midis secilit anëtar dhe Shoqatës;
6. Nisja dhe mbarëvajtja e procedurave të mbrojtjes në rastet e shkeljes së të drejtave që Shoqata u administron anëtarëve të saj;



3

7. Administrimi i fondeve të mbledhura, duke mbajtur parasysh se shpenzimet totale të Shoqatës nuk mund të përbëjnë më shumë se 30% e shpërblimeve të shpërndara;
8. Organizimi i aktiviteteve publike me karakter sensibilizues dhe informues në funksion të përmbushjes së aktivitetit të saj;
9. Në aktivitetin e saj, Shoqata mbështetet në parimin e transparencës, parimin e evitimit të konfliktit të interesit në organet drejtuese, si dhe parimin e mosdiskriminimit të autorëve-anëtarë, si dhe përdoruesve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

Neni 4

Ndalimi i shpërndarjes së fitimit

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit material e financiar, nga të ardhurat e Shoqatës prej personave, që janë subjekte që emërohen apo punësohen në Shoqatës nëpërmjet dispozitave të këtij Statuti, përveç detyrimeve në formën e pagesave, rrogave, shpërblimeve, honorareve dhe kompensimeve, që rrjedhin nga kontrata e punës/shërbimit/bashkëpunimit ose kontrata të tjera për kryerjen e shërbimeve për llogari të Shoqatës. Këtu nuk përfshihet shpërndarja e shpërblimeve të anëtarëve të Shoqatës Shoqatës, të cilët duhet të jenë autorë sipas përcaktimit të bërë në nenin 1, pika 2 të këtij Statuti.

Neni 5

Kohëzgjatja

1. Shoqata ngrihet dhe do të funksionojë për një afat kohor të pacaktuar. Përfundimi i veprimtarisë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës ose në rast se janë rrethanat me vendim të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, sipas kushteve të parashikuara në nenin 44 të ligjit Nr. 8788 dt. 7/5/2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", të ndryshuar.

2. Shoqatës, konform legjislacionit në fuqi plotëson dokumentacionin ligjor dhe aplikon konform procedurave ligjore në fuqi, pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, për t'u liçensuar si agjenci e administrimit kolektiv për mbrojtjen e të drejtave të autorëve që përfaqëson.

Neni 6

Organet drejtuese

Organet e Shoqatës "SHOQATA E FILMIT AUDIOVIZUAL, ARTISTIK DHE DOKUMENTAR, janë:

1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Bordi Drejtues;
3. Drejtori Ekzekutiv.
4. Asambleja e Asociuar.
5. Komisioni I Posaçëm



[Handwritten signatures]



2

Neni 7 *Asambleja e Përgjithshme*

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Shoqatës. Ajo përbëhet nga anëtarët e Shoqatës, që janë regjistruar në Regjistrin e Gjykatës, konform rregullave të përcaktuara në Statut.

2. Asambleja e Përgjithshme, e cila si rregull duhet të mbledhet një herë në vit, ka këto kompetenca:

- a) përgatit propozimet eventuale për ndryshime në Statut dhe i dërgon ato për miratim nga ministri përgjegjës për të drejtat e autorit;
- b) miraton ndryshimet në Statutin e Shoqatës, pasi ministri përgjegjës për të drejtat e autorit ka dhënë miratimin për ndryshimet e propozuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- c) miraton dhe ndryshon Rregulloren e Shoqatës;
- b) vendos lidhur me drejtimit kryesore të veprimtarisë së Shoqatës;
- c) diskuton dhe miraton raportet lidhur me veprimtarinë e organeve të tjera drejtuese të Shoqatës;
- d) zgjedh Bordin Drejtues të Shoqatës F.A.A.D.;
- e) monitoron performancën e organeve drejtuese të Shoqatës dhe miraton përfitimet monetare dhe jomonetare, si dhënie pensionesh apo titujsh, të drejta dhe shpërblime të tjera ose të drejtat për pagesa kalimtare, brënda kostove të administrimit;
- f) përjashton nga Shoqatës anëtarët, që nuk respektojnë dispozitat e këtij statuti dhe kanë shkelur në vijimësi kontratën me Shoqatën. Propozimi i paraqitet Asamblesë nga Bordi Drejtues në formën e një raporti të arsyetuar lidhur me rastet përkatëse;
- g) miraton masën dhe mënyrën e derdhjes së kuotizacionit vjetor të anëtarëve të Shoqatës dhe shpërndarjen e shpërblimeve të mbledhura sipas tarifave të caktuara nga Bordi Drejtues i Shoqatës;
- gj) miraton çdo blerje, shitje ose hipotekim të pasurisë së paluajtshme;
- h) vendos shpërndarjen e Shoqatës.

7.3. Asambleja e Asociuar

7.3/1 Asambleja e asociuar përbëhet nga të gjithë anëtarët që kanë kontratë përfaqësimi me F.A.A.D por nuk janë të regjistruar në Gjykatë.

7.3/2 Anëtarët e Asamblesë së Asociuar kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së përgjithshme por pa të drejtë vote.

7.3/3 Anëtarët e Asamblesë së Asociuar nuk mund të përfaqësojnë shoqatën, por mbajnë detyrimin të përgjigjen thirrjes kur kërkohen për Interesat e Shoqatës. Nëse nuk i përgjigjen Shoqatës, përjashtohen nga benefitet që mund të perfitojnë nga Komisioni i posaçëm.

Neni 8 *Organizimi i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme*

1. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit me vendim të Bordit Drejtues së Shoqatës.

2. Njoftimet për mbledhjen bëhen nga Drejtori Ekzekutiv i cili bashkë me njoftimin për datën, orën dhe vendin e mbledhjes dërgon edhe rendin e ditës për mbledhjen.





3. Njoftimi bëhet jo më vonë se një muaj para datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
4. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të saj.
5. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se 3/4 e anëtarëve.
6. Asambleja e Përgjithshme i merr vendimet e saj me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Shoqatës.
7. Vendimet për shpërndarjen e Shoqatës merren me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë anëtarëve.
8. Asambleja vendos për politikën e përgjithshme për shpërndarjen e shpërblimeve ndaj mbajtësve të të drejtave dhe shpenzimeve të administrimit të të drejtave.
9. Tekstet e rezolutave të propozuara dhe të gjitha dokumentat e tjera të nevojshme për informimin e anëtarëve iu vihen në dispozicion sipas kërkesës së tyre para votimit.
10. Mbledhja e jashtëzakonshme, mund të kërkohej vetëm me shkrim nga 1/4 e anëtarëve, në rast kur nuk ka përgjigje nga Bordi ose Drejtori ekzekutiv, të pa justifikuar dhe për më shumë se 3 herë nga kërkesa për mbledhje të Asamblesë nga 1/4 e anëtarëve të regjistruar në Gjykatë.

Neni 9

Bordi Drejtues i Shoqatës F.A.A.D

1. Anëtarët e Bordit Drejtues të Shoqatës zgjidhen në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me votë të fshehtë për një afat kohor 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Bordi Drejtues përbëhet prej 5 anëtarësh me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Quhen të zgjedhur si anëtarë të Bordit ata persona të cilët marrin numrin më të madh të votave të Shoqatës së Përgjithshme.
4. Bordi Drejtues drejton veprimtarinë e Shoqatës në periudhën kohore midis dy mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Bordi Drejtues i Shoqatës ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) vendos lidhur me mënyrën e zbatimit të strategjive afatgjata, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, mënyrën e përmbushjes së qëllimeve të Shoqatës në përgjithësi;
 - b) përcakton prioritetet për projektet dhe financimin e tyre;
 - c) përcakton rregulla për veprimtarinë financiare të Shoqatës, shpërndarjen sipas tarifave të mbledhura dhe shpërblimeve për anëtarët dhe ia propozon këto Asamblesë, si dhe mbikqyr zbatimin e tyre;
 - d) vendos për përjashtimin e anëtarëve të Shoqatës, të cilët nuk respektojnë përcaktimet e bëra në këtë statut;

12

- e) përcakton rregullat e funksionimit, strukturën, përshkrimin e punës dhe pagat e administratës së Shoqatës, honoraret dhe shpërblimet për ekspertët që angazhohen në veprimtaritë e Shoqatës me propozim të Drejtorit Ekzekutiv.
- f) përcakton dhe i propozon për miratim Asamblesë masën dhe mënyrën e derdhjes së kuotizacionit vjetor të anëtarëve;
- g) miraton formatin e kontratës që lidhet me Shoqatën dhe çdo anëtar të saj. Bordi Drejtues autorizon me shkrim Drejtorin Ekzekutiv për nënshkrimin e kontratave individuale;
- h) përcakton tarifat për transmetimin e veprave në bashkëautorësi të anëtarëve të Shoqatës;
- i) informon, sipas kërkesës, anëtarët për mënyrën e shfrytëzimit të të drejtave të tyre, për raportin vjetor financiar dhe atë të kontrollit të të ardhurave financiare, brenda një afati kohor 1 (një) vjeçar;
- j) kontrollon dhe miraton administrimin financiar dhe ekonomik të Shoqatës;
- k) përcakton masën e shpërblimit mujor të Drejtorit Ekzekutiv dhe shpërblimet vjetore të anëtarëve të vet.

5. Bordi Drejtues i Shoqatës mbledhet jo më pak se 4 herë në vit dhe i merr vendimet e tij me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

6. Mbledhjet e Bordit Drejtues janë të vlefshme kur në to marrin pjesë të paktën 3 anëtarë. Vendimet merren me shumicën e votave. Në rastet e barazisë së votave, vota e Drejtorit Ekzekutiv përcakton shumicën.

7. Në rast se krijohet një vend vakant në Bord përpara përfundimit të mandatit, Asambleja e Përgjithshme zgjedh një anëtar të ri zëvendësues në mbledhjen e vet të radhës. Anëtar i ri shërben në detyrë deri në përfundim të mandatit të anëtarit që zëvendëson.

Neni 10

Drejtori Ekzekutiv i F.A.A.D

1. Bordi Drejtues, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh Drejtorin Ekzekutiv me votim unanim. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga jashtë shoqatës dhe nuk duhet të ketë asnjë lidhje familjare me anëtarët apo të jetë/ketë punuar në një nga fushat e të drejtave që mbrohen nga kjo Shoqatë, me qëllim shmangjen e konfliktit të Interesit. Drejtori ekzekutiv duhet të jetë Avokat i licencuar dhe me experience jo më pak se 5 vite në fushën e të drejtave të autorit dhe Audiovizualit. Drejtori Ekzekutiv drejton mbledhjet e Bordit Drejtues dhe veprimtarinë e përditshme të Shoqatës.

2. Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës F.A.A.D kryen funksionet e mëposhtme:

- a) drejton veprimtarinë e Shoqatës në periudhën kohore midis mbledhjeve të Bordit Drejtues;
- b) drejton mbledhjet e Bordit Drejtues dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të marra prej tij;
- c) përfaqëson Shoqatën para organeve shtetërore si dhe në marrëdhëniet me të tretët;



[Handwritten signatures]

13

d) harton dhe i propozon Bordit Drejtues rregullat e funksionimit, strukturën, përshkrimin e punës dhe pagat e administratës së Shoqatës, honoraret dhe shpërblimet për ekspertët që angazhohen në veprimtaritë e Shoqatës;

e) emëron dhe shkarkon personelin sipas rregullave për strukturën e administratës së Shoqatës të miratuar nga Bordi Drejtues;

dh) lidh kontrata shërbimi apo çdo lloj kontrate tjetër me të tretët sipas vendimeve përkatëse të Bordit Drejtues;

f) përgatit raportin e shpërndarjes së shpërblimeve për anëtarët e Shoqatës së bashku me raportin mbledhjeve veprimtarinë vjetore të kësaj të fundit dhe ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

3. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv është pesë vite, me të drejtë rizgjedhjeje.

4. Bordi Drejtues mund të vendosë shkarkimin dhe zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv me votë unanime. Në këtë rast vota e personit të propozuar apo zgjedhur si Drejtor Ekzekutiv, është e pavlefshme.

Neni 11

Anëtarët

1. Anëtarësimi në Shoqatës është vullnetar dhe i hapur për të gjithë personat madhorë, me zotësi për të vepruar, që janë shtetas shqiptarë, persona fizik ose juridik dhe gëzojnë cilësinë e titullarit të të drejtave për bashkëautorësinë e veprave audiovizuale në zërin Producent, regji, skenar, në kuptimin e ligjit nr. 35, datë 31.03.2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to".

2. Anëtarët e Shoqatës në momentin e anëtarësimit pranojnë në parim të drejtën e Shoqatës për mbrojtjen e të drejtave të tyre të autorësisë sipas rregullave të përcaktuara në këtë statut.

3. Anëtarët e Shoqatës nënshkruajnë kontrata individuale me Agjencinë për mbrojtjen e të drejtave të veta si autor në veprat audiovizuale ku janë bashkëautorë.

4. Anëtarët e Shoqatës paguajnë kuotizacion vjetor sipas kuotës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme.

5. Autori-anëtar përfaqësohet në Shoqatë me të drejtat e veta në veprat ku është autor, ose me titujt që gëzon në veprat e përbashkëta me autorë të tjerë, të cilat përcaktohen në kontratën që lidh me Agjencinë.

6. Çdo anëtar ka të drejtën të paraqesë dorëheqjen me shkrim dhe prishjen e kontratës me Agjencinë, të paktën një javë para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kur është njoftuar për organizimin e saj, sipas statutit. Në këtë rast të drejtat e tij i kthehen vetëm në muajin e fundit të vitit në të cilin është paraqitur dorëheqja.

7. Anëtari i shoqatës, konsiderohet i vetëpërgjashtuar nga Shoqata, në rast se:

a) Nuk merr pjesë të paktën në tre mbledhje të përgjithshme të anëtarëve të Shoqatës;

b) Nuk paguan kuotizacionin, për të paktën dy vjet;

8. Kur konstatohet se një anëtar i Shoqatës kryen veprime të cilat janë në kundërshtim me parashikimet e bëra në Statut, si dhe me parimet kryesore të Shoqatës, ai përjashtohet nga Shoqata.

9. Bordi Drejtues i Shoqatës merr vendim për përjashtimet e anëtarëve nga Shoqata.

10. Anëtarët, kanë të drejtë të marrin informacione lidhur me vlerësimin e të drejtës së tyre të shpërblimit, apo masën e shpërblimit. Procedura për marrjen e informacionit, mënyrën e

[Handwritten signatures and initials]

kërkimit, apo e drejta e ankimit përcaktohet në Rregulloren e Brendshme të Shoqatës, e cila miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të thjeshtë votash.

11. Në rast se ka kundërshtime, secili ka të drejtë me shpenzime të vetat të marrë një auditues të jashtëm, me shpenzime nga vetë ai.

Neni 12

Përfaqësimi ligjor

1. Shoqata F.A.A.D përfaqësohet në marrëdhëniet me të tretët, qofshin këta persona fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, publikë apo privatë nga Drejtori Ekzekutiv.

2. Drejtori Ekzekutiv mund t'ia delegojë përkohësisht tagrin e përfaqësimit një anëtar tjetër të Bordit Drejtues të caktuar prej tij me anë të një autorizimi me shkrim, ku të jenë përcaktuar taksativisht kompetencat, që ka deleguar dhe shtrirjen kohore të veprimtarisë së delegimit.

3. Drejtori Ekzekutiv dhe në mungesë të tij një anëtar i Bordit Drejtues me autorizim të këtij të fundit dhe miratimin me shkrim të Drejtorit Ekzekutiv, në rast mungese të përkohshme (jo më shumë se 3 muaj) nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv, përfaqësojnë ligjërisht Shoqatën në rast konfliktesh gjyqësore ose marrëdhënie të tipit kontraktual me të tretët.

4. Në rastin kur përfaqësimi kryhet nga një antar i Bordit Drejtues, ky i fundit raporton veprimet e tij në mbledhjen me të parë të Bordit Drejtues.

Neni 13

Të ardhurat, financimi dhe administrimi i fondeve të Shoqatës F.A.A.D

1. Asambleja e Përgjithshme miraton rregullat dhe modalitetet për administrimin e fondeve dhe të ardhurave të Shoqatës.

2. Asetet financiare dhe materiale të Shoqatës menaxhohen nga Drejtori Ekzekutiv.

3. Bordi Drejtues i Shoqatës mbikqyr respektimin e rregullave dhe modaliteteve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme për administrimin e fondeve dhe të ardhurave të Shoqatës.

4. Kapitali i Shoqatës është i ndryshueshëm. Ai formohet nga:

a) vlerat që mbliidhen nga kuotat e anëtarësisë,

b) të ardhurat e krijuara për mbulimin e kostove të administrimit, nuk mund të jenë më shumë se 30% e vlerës së shpërblimeve të shpërndara mbajtësve të të drejtës së autorit që përfaqëson

c) dhuratat, sponsorizimet ose financimet që bëhen për Shoqatën nga të tretët.

5. Financimi i veprimtarisë së Shoqatës kryhet nga fonde që sigurohen nga:

a) kuotizacionet e anëtarëve dhe përqindjet mbi tarifat e mbledhura nga transmetimi i veprave të anëtarëve të Shoqatës sipas marrëveshjes individuale midis tyre dhe Shoqatës, e caktuar për mbajtjen e kostove administrative sipas pikës 4 më sipër,

b) dhurime, ndihma, sponsorizime dhe financime nga persona, subjekte e institucione publike e private, brenda apo jashtë vendit, të depozituara në mënyrë të drejtëpërdrejtë e pa kushte për llogaritë e Shoqatës;

c) interesat e siguruara nga depozitat bankare;

d) veprimtaritë ekonomike të Shoqatës të lejuara sipas ligjit;

[Signature]

[Signature]

- e) nga financime e burime të tjera të ligjshme.
6. Administrimi i fondeve apo pasurive ekzistuese ose që do t'i shtohen Shoqatës në të ardhmen kryhet sipas Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", të ndryshuar, Statutit dhe rregullores së Shoqatës, si edhe kontratës apo marrëveshjes me financuesit nëse ka.
7. Shoqata mban dokumentacionin kontabël për të gjithë veprimtarinë ekonomike të ushtruar prej saj sipas standardeve përkatëse të përcaktuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi.
8. Shoqatës ka llogaritë e saj bankare, për çeljen ose mbylljen e të cilave merr vendim Bordi Drejtues me propozim të Drejtorit Ekzekutiv.
9. Viti financiar i Shoqatës korrespondon plotësisht me vitin kalendarik që fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
10. Shuma e përgjithshme e shpenzimeve, përfshin edhe mjetet financiare të shpenzuara në përmirësimin e sistemit të administrimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të.

Neni 14

Komisioni I posacëm

Komisioni I Posacëm, përbëhet nga 3 persona të cilët zgjidhen nga Asambleja dhe nuk janë pjesë e Bordit Drejtues.

Ky Komision krijohet sipas përcaktimeve të LDA 35/2016. Funkcionet e tij, përvec atyre të përcaktuara në LDA 35/2016 janë edhe;

- a) Miratimi i shpërblimeve për autorët që kanë ndërruar jetë ose ndërrojnë jetë;
- b) Miratimi për mbështetje Financiare shëndetësore;
- c) Miratimi i restaurimit të filmave të anëtarëve;

Të gjitha këto vendime, duhet të miratohen nga Asambleja e përgjithshme me $\frac{3}{4}$ anëtarëve të regjistruar në Gjykatë. Këto fonde miratohen vetëm në fund të vitit financiar, dhe vetëm pasi miratohet pjesa takuese për tu shpërndarë anëtarëve të Shoqatës.

Neni 15

Marrëdhëniet e Punës

Punësimi në administratën e Shoqatës rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë. Struktura e administratës së Shoqatës Shoqatës përcaktohet nga Drejtori Ekzekutiv. Për çdo rast brënda kostove të administrimit, duke respektuar rregullat e përcaktuara në këtë Statut dhe në Rregulloren e Shoqatës për administrimin dhe kreyrjen e shpenzimeve.

Neni 16

Konflikti i Interesave dhe Marrëveshjet e Ndaluara

1. Ndalohet çdo konflikt i interesave ndërmjet Shoqatës dhe anëtarit të organit vendimmarrës, ekzekutiv ose punonjësit të saj.
2. Asnjë anëtar i organeve drejtuese të Shoqatës nuk mund të marrë pjesë në një proces vendimmarrës në lidhje me të cilin ai/ajo ka interes personal direkt ose indirekt.
3. Transaksionet ekonomike dhe marrëveshje të tjera ndërmjet Shoqatës dhe një anëtarit të organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive ose një punonjësi të saj, mund të lejohen vetëm nëse

[Signatures]

16

ato lidhen për të përmbushur një qëllim ose objekt të veprimtarisë së Shoqatës, vetëm nëse janë të drejta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e Shoqatës.

4. Këto marrëveshje dhe transaksione lejohen vetëm nëse shqyrtohen paraprakisht dhe miratohen nga Bërdi Drejtues. Personat e interesuar duhet të përjashtohen nga diskutimet dhe votimi për marrëveshjen ose transaksionin.

Neni 17

Përgjegjësia ndaj të tretëve

Anëtarët e Bërdit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv si edhe punonjësit e administratës së Shoqatës nuk përgjigjen individualisht për detyrimet e kësaj të fundit ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve, kur personalisht i kanë shkaktuar dëm të tretëve gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje ose nga pakujdesia apo vetbesimi në shkeljeve të ligjit dhe Statutit e Rregullores së Shoqatës.

Neni 18

Transformimi, ndarja dhe bashkimi

1. Shoqata mund të transformohet, ndahet, apo bashkohet me një OJF tjetër, me iniciativën e saj me vendimmarje të Asamblesë me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve.
2. Gjithashtu, me vendimmarje të Asamblesë me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve, nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim Shoqatës mund të bjerë dakort me një agjenci tjetër dhe të vendosë për transferimin e funksioneve të saj.
3. Në pamundësi të arritjes së një marrëveshjeje sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij neni, do të zbatohen dispozitat e ligjit për të drejtën e autorit në fuqi.

Neni 19

Shpërndarja

1. Shoqata shpërndahet me iniciativën e saj me vendimmarje të Asamblesë me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve.
2. Anëtarët e Shoqatës si dhe organet drejtuese mund t'i kërkojnë gjykatës shpërndarjen e Shoqatës në rastet e mëposhtme:
 - a) veprimtaria e Shoqatës vjen në kundërshtim me Kushtetutën;
 - b) Shoqatës kryen veprimtari të kundërligjshme;
 - c) Shoqatës nuk është themeluar sipas kërkesave të ligjit;
 - d) Shoqatës ka falimentuar sipas ligjit për falimentimin.
3. Në rast se Shoqatës shpërndahet me iniciativën e saj, jo më vonë se një javë nga data e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për shpërndarjen, Bërdi Drejtues cakton dy likuidatorë me profesion respektivisht jurist dhe ekonomist.
4. Likuidatorët kanë autoritet të plotë mbi asetet e Shoqatës Shoqatës dhe për përfaqësimin e saj në marrëdhëniet me të tretët që nga dita e emërimit të tyre.

Neni 20

Shpërndarja me vendim gjykate

15



17

Gjykata mund të vendosë shpërndarjen e Shoqatës, në rrethanat e parashikuara në ligj. Në rast shpërndarje të Shoqatës me vendim të Gjykatës, të gjitha kompetencat që ka Bordi Drejtues lidhur me shpërndarjen e likujdimin, i kalojnë Gjykatës, sipas procedurës së përcaktuar në ligj.

Neni 21

Destinacioni i pasurisë pas mbylljes së Shoqatës

Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për mbarimin e aktivitetit të Shoqatës Bordi Drejtues i saj vendos për destinacionin e pasurive të Shoqatës në favor të një ose disa organizatave jo fitimprurëse me qëllime dhe aktivitete të ngjashme.

Në asnjë rast nuk mund të vendoset shpërndarja e pasurisë së Shoqatës tek themeluesit, anëtarët, stafi, donatorët dhe të afërmit e tyre.

Neni 22

Likuidimi

Likujduesi përfaqëson Shoqatën dhe ka të gjithë përgjegjësitë e kompetencat e nevojshme mbi pasurinë e Shoqatës, që nga dita e emërimit deri në likuidimin përfundimtar konform legjislacionit në fuqi.

Likujduesi brenda 2 muajve nga data e emërimit të tij, thërret mbledhjen e Bordit Drejtues dhe i paraqet këtij të fundit raportin mbi gjendjen financiare, aktivin dhe pasivin e Shoqatës, përpara se të fillojë operacionin e likuidimit.

Raporti përfundimtar i përgatitur nga likuidatorët miratohet nga Bordi Drejtues dhe më pas kjo e fundit kërkon regjistrimin e Shoqatës në gjykatë kompetente. Kur Bordi Drejtues refuzon miratimin e Raportit Përfundimtar, çështja zgjidhet nga gjykata kompetente.

Bordi Drejtues pas miratimit të Raportit Përfundimtar të likuidimit, merr vendim për shpërndarjen, në të cilin përcakton organizatat jofitimprurëse, brenda apo jashtë Shqipërisë, të cilave do t'u kalojë pasuria e mbetur si dhe pjesën takuese të secilës.

Neni 23

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis organeve vendimmarrëse dhe Shoqatës, ose ndërmjet tyre dhe të punësuarve, si dhe midis Shoqatës dhe të tretëve zgjidhet me mirëkuptim. Në të kundërt Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre.

Neni 24

Ndryshimet në Statut

1. Çdo ndryshim i këtij Statuti si dhe miratimi e ndryshimi i Rregullores së Shoqatës, të miratuar në zbatim të tij, bëhet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të cilësuar ose

145

SEKRETARIAT I ASAMBLEJES

[Signature]

18

¾ e e të gjithë anëtarëve, në bazë të propozimit të miratuar paraprakisht dhe të paraqitur në Asamble nga Bordi Drejtues.

2. Çdo propozim për ndryshimin e statutit është objekt i miratimit nga ministri përgjegjës për të drejtat e autorit.

Neni 25
Dispozitat e fundit

Për gjithçka që nuk është parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ANËTARË THEMELUES

1. Esat Musliu Esat Musliu Elshuf
2. Spartak Pecani Spartak Pecani
3. Besim Kurti Besim Kurti
4. Bujar Kapexhiu Bujar Kapexhiu
5. Zamir Kokonozi Zamir Kokonozi
6. Saimir Kumbaro Saimir Kumbaro
7. Eno Milkari Eno Milkari

